V E N D I M
Nr.415, datë 17.8.1993

PËR LICENCIMIN E IMPORTIT, EKSPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË E PAKICË TË LËNDËVE DEZINFEKTANTE, DEZINSEKTANTE E DERATIZUESE

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinsektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe policia financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi